Teksti i libretit të filmit dokumentar

“NJË EMËR QË NUK HARROHET”

Kushtuar jetës së heroinës së Malësisë së Gjakovës

CUCË AVDYLJA – ULAJ

v

Shkruar nga Mal Berisha

Epilog: Rrëfim personal mbi përshtypjet nga njohja me Cucë Avdylen

E kam takuar për herë të parë Cucë Avdylen në shtatorin e vitit 1966. Familja jonë ishte e dëbuar politikisht nga vendlindja jonë në Tropojë dhe ishte vendosur në grykën e Lumit Drojë, në fshatin Shpërdhet, nw Mamurras. Në rrethanat e atëhershme, gjendja jonë në çdo aspekt ishte e mjerueshme. Nuk njihnim askënd, ndërsa pushteti ishte shumë armiqësor, pasi na konsideronte të padëshirueshëm, si të dëbuar politikë që ishim. Në ditët e para të qëndrimit aty, na mungonin edhe ushqimi dhe streha e duhur.

Pas disa ditësh nga vendosja jonë atje, në oborrin e asaj shtëpie të vjetër, të pabanuar ndoshta prej një shekulli, ku po mundoheshim të kthenim jetën, u duk një zonjë me shami të bardhë, e plotë në fytyrë, e qeshur, që ngjallte respekt dhe shpresë sapo ta shihje.

Ishte Cucë Avdylja!

Atëbotë, ajo mund të ketë qenë në moshën mbi 70-vjeçare. Trupdrejtë, e bëshme, e kthjellët dhe plot shprehje fisnike, ardhja e saj ishte si një rreze dielli që binte mbi një vend të shkretë.

Dashuria dhe mirësia e saj janë të pashlyeshme dhe të paharrueshme. Ajo të ngushëllonte me fjalë dhe të qetësonte me sjelljen e saj. Lidhja ime me atë trimëreshë rridhte nga gjaku i përbashkët që kishte nëna ime me të, pasi gjyshja ime nga nëna – Fatime Manja – ishte bijë në një derë me Cucën dhe kishin kaluar disa vite të fëmijërisë bashkë. Ato ishin krenare për origjinën nga shtëpia e Deli Qerimit. Ishte kjo arsyeja e trokitjes së Cucë Avdyles në derën tonë atë ditë të shtatorit të vitit 1966.

*****

Ky film dokumentar kushtuar heroinës së Malësisë së Gjakovës dhe Plavë e Gucisë, Cucë Avdylja – Ulaj, ka si qëllim të ngjallë ndjenjat e krenarisë sonë kombëtare, duke e parë figurën e saj në planin e sakrificave mbinjerëzore që karakterizojnë patriotët. e vërtetë.

Autori

Hyrje – Kush ishte Cucë Avdylja – Ulaj?

Cucë Avdylja lindi në fshatin Geghysen të Malësisë së Gjakovës, në vitin 1892. Ajo ishte bija e familjes së njohur të Qerimajve të Geghysenit, një familje që ruante me përkushtim traditat më të mira të krahinës dhe që njihej për kontributin e vyer në Lidhjen e Prizrenit. Sidomos shquhej për mbështetjen që i dha malësorëve kryengritës të Gjakovës kundër Mehmet Pashë Maxharrit dhe Abdullah Pashë Drenit, në javën e parë të shtatorit të vitit 1878.

Në atë përballje historike u dallua trimëria e vëllezërve Qerim dhe Col Delia nga Geghyseni. Coli ra dëshmor gjatë sulmit ndaj sarajeve të Abdullah Pashës, dhe heroizmi i tij u përjetësua në këngën popullore:

"Col Delia sy-sahati,
I lumtë goja mirë vikati,
Vetë po shkoj, Pashën po e çarti!"

Pikërisht nga kjo derë rridhte Cucë Avdylja, e Avdyl Qerimit të Qerim Delisë. Cucë Avdylja u rrit në atë mjedis anti – Osman, ku flitej për trimëri dhe legjenda. Një korë burrash përherë i rrinte si kurorë lavdie atij fshati të vendosur në një pikë të lartë natyrore me bukuri të rralla. I gjithë fshati ishte i mbuluar me gjelbërim në stinët e ngrohta dhe me borë që zgjastë me muaj. Kunorat e gështenjëve e zbukuronin nga ana natyrore dhe e begatonin më frutat e tyre atë zonë me pak tokë buke.
Geghyseni, ashtu si e gjithë Malësia e Gjakovës, në prag të rënies së Perandorisë Osmane dhe menjëherë pas saj, po ndiente rrezikun e copëtimit të trojeve shqiptare në favor të Malit të Zi. Në anën perëndimore të Kosovës, tokat e Plavës dhe Gucisë po i jepeshin si dhuratë malazezëve.
Në Malësi, herë pas here, kalonin ekspedita ushtarake malazeze të sponsorizuara nga Knjazi i Malit të Zi dhe Rusia Cariste. Malësorët detyroheshin të luftonin me ato pak armë që kishin, të fshehura nga patrullat ushtarake osmane.

Episodi 1 - Ukshin Avdyli i rënë kundër malazezëve – Cucë Avdylja e plagosur

Në vitin 1915, në vazhdën e ekspeditave ushtarake në Malësinë e Gjakovës, forcat malazeze sulmuan fshatin Geghysen, i cili u bë i pari që u përball me ta. Në atë betejë, që ruhet në kujtesën popullore me vargjet:

"Karadaku me petica,
Geghyseni me sakica,"

iu desh të ndesheshin trup më trup djemtë dhe vajzat e fshatit.

Një ndër ta ishte Ukshin Avdyli, vëllai i Cucë Avdyles. Ndërsa po luftonin, një malazez e qëlloi Ukshinin me plumb, duke e lënë të vrarë në vend. Por aty ndodhej edhe e motra, Cuca, ende fare e re, e cila i rrëmbeu pushkën një malazezi tjetër dhe e qëlloi vrasësin e vëllait, duke e lënë të vdekur në vend.
Një tjetër shkja e goditi atë me bajonetë nën sqetull. Në atë kohë, Cuca ishte në prag të martesës, dhe thuhet se plagët ia mjekoi vjehrri i saj i ardhshëm, Hysen Mashi – një gjest krejt i pazakontë për kohën.

Një ngjarje e tillë, në atë kohë, bëri bujë të madhe dhe u kthye në burim frymëzimi për rezistencën anti-sllave që do të mbronte kufijtë e Shqipërisë.
Heroizmi i Cucë Avdyles, në atë kohë, krahasohej me atë të Norës së Kelmendit – heroinës që kishte lindur dhe luftuar në ato bjeshkë të Malësisë së Gjakovës, në Kelmend, apo më gjerë në Malësinë e Madhe.
Po ashtu, emri i saj vihej krah Tringë Smajlës, heroinës tjetër malësore nga Gruda, e cila mori pjesë në Memorandumin e Greçes në qershor të vitit 1911 dhe në ngritjen e flamurit në Deçiç në prill të vitit 1912.

Të dyja këto figura, tashmë të njohura në Historinë e Shqipërisë, përfaqësonin frymëzim për gruan shqiptare të Veriut. Dhe pikërisht në odat e burrave, ku u rrit Cucë Avdylja, ato ishin shembuj të gjallë frymëzimi dhe krenarie kombëtare.

Episodi 2 - Martesa e Cucë Avdyles

Erdhi edhe dita që kjo trimëreshë të martohej me Elez Hysenin, të birin e Hysen Mashit, në fshatin Vuthaj. Ai rridhte nga një derë e madhe fisnike vuthjane, e njohur në Plavë e Guci për burrni, trimëri, bujari dhe për Besën Shqiptare.

Martesa e saj ndodhi në një kontekst të thellë patriotik, në një lidhje të shenjtë me zonat e egra malore, të izoluara për shkak të mungesës së rrugëve dhe rreziqeve të shumta që vinin nga patrullimet ushtarake të qeverive sllave të Knjazëve malazezë, e më pas të Jugosllavisë së Parë.

Cuca u bë nuse e një dere të madhe dhe i dhuroi familjes Ulaj të Vuthajve gjashtë fëmijë: tre djem – Isën, Imerin dhe Ahmetin, dhe tre vajza – Shemën, Baden dhe Fatimen. Secili prej tyre, më i bukur dhe më i hijshëm se tjetri.

Koha po ecte dhe jeta po ndryshonte. Shqipëria ishte çliruar nga osmanët, por zona të tëra kishin rënë nën pushtimin sllav. Plava dhe Gucia, sipas marrëveshjes së Shën Stefanit të vitit 1878, u dhuruan sllavëve.

Lidhja e Prizrenit bëri rezistencë të fortë, por nuk arriti ta pengonte këtë ndarje, ashtu siç nuk mundi të shpëtonte as Hotin e Grudën, Ulqinin dhe Tivarin. Konferenca e Londrës e sanksionoi plotësisht këtë ndarje, duke përcaktuar hartën politike të një Shqipërie të cunguar, ku Malësia e Gjakovës mbeti brenda kufijve të Shqipërisë, por Kosova në verilindje dhe Plava e Gucia në veriperëndim iu dhuruan sllavëve të jugut.
Për një farë kohe, komunikimi midis shqiptarëve të mbetur në Malin e Zi vazhdoi pa ndonjë pengesë të madhe, deri në vitin 1918, kur u shpall Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene. Mali i Zi u bë pjesë e saj më 1 dhjetor të po atij viti.
Sundimi i Jugosllavisë së Parë e vështirësoi ndjeshëm lidhjen midis qytetarëve të kësaj mbretërie artificiale dhe shqiptarëve matanë kufirit. Në këtë realitet të ri, edhe kontaktet e një bije të Malësisë së Gjakovës, Cucë Avdyles – tashmë nuse në Vuthaj të Plavës e Gucisë – u bënë gjithnjë e më të vështira.

Ajo ishte motra e martuar larg, që për të afërmit e saj filloi të merrte trajtat e një figure legjendare, ashtu si në legjendën shqiptare të Konstandinit dhe Doruntinës.

Episodi 3: Lufta e Dytë Botërore.

Bijtë e Geghysenit, të mëkuar me dashurinë për Atdheun dhe të gatshëm të sakrifikojnë për të në çdo kohë, ishin ndër të parët që iu bashkuan Lëvizjes Nacionalçlirimtare për të luftuar kundër fashizmit italian dhe nazizmit gjerman.

Ata u përfshinë në formacionet luftarake të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, veprimtaria e së cilës u shtri edhe përtej kufijve politikë të njohur të Shqipërisë nga Lidhja e Kombeve në vitin 1923.

Në fund të dhjetorit të vitit 1943, në një fshat krejt pranë Geghysenit, u mbajt Konferenca e Bujanit, e cila sanksionoi – por që më vonë u tradhtua – bashkimin e trojeve shqiptare, pasi të kishte rënë nazizmi hitlerian dhe të ishin çliruar të gjitha tokat shqiptare.

Kjo konferencë, që përbënte një vazhdimësi të asaj të Mukjes, sillte një farë pajtimi mes grupeve të ndryshme politike shqiptare dhe ngjallte shpresa të mëdha për një të ardhme të përbashkët të shqiptarëve, të cilët në atë kohë ishin të ndarë në disa shtete dhe nën pushtim nazist.

Episodi 4 - Ahmet Elezi, dëshmori më i ri i Luftës Nacional-Çlirimtare

Tropoja, qendra e nënprefekturës së Malësisë së Gjakovës, u çlirua më 16 tetor 1944. Menjëherë pas çlirimit, aty u formua një njësi e re e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, sipas urdhrit të Komandës së Përgjithshme të datës 25 tetor 1944.

Pas pak ditësh, më 6 nëntor 1944, në qendër të Tropojës – në Aste – u formua Brigada e XXV-të Sulmuese. Kjo brigadë mori urdhër që një pjesë e mirë e trupave të saj të marshonte drejt Plavës dhe Gucisë, për çlirimin e tyre nga gjermanët.

Pikërisht në atë kohë, një grup partizanësh të Brigadës së XXV-të Sulmuese, bij të Geghysenit, kaluan nëpër Vuthaj. Aty gjetën strehë, bukë dhe mikpritje nga bija e tyre e dashur – nëna e gjashtë fëmijëve – Cucë Avdylja.

Në largim prej andej, Cuca ua "fali" djalin e saj, Ahmetin 16-vjeçar, i cili doli partizan për çlirimin e Atdheut. Ai ishte një adoleshent i ri, shtatlartë, i edukuar me dashuri për vendin dhe i rritur me ndjenjën e atdhedashurisë në të dy anët e familjes së tij.

Kështu, ai djalosh i njomë ende, ishte veç një kërthi kur veshi uniformën e partizanit. Por fati i tij do të ishte tragjik.

Ahmet Elez Ulaj nuk do të kthehej më në shtëpinë e tij. Natën e 23 nëntorit 1944, forcat partizane ndërmorën një ofensivë në Theth të Dukagjinit, në Kodër-Shëngjergj dhe në Letaj. Në këto luftime, Ahmeti u vra, duke u bërë dëshmori i parë i Brigadës së XXV-të Sulmuese – i mobilizuar vetëm disa ditë më parë.

Kështu, Cucë Avdylja përjetoi tragjedinë e humbjes së djalit të saj, dëshmor i atdheut, varrin e të cilit nuk do ta shihte për afro dy dekada. Ahmeti u varros në varrezat e dëshmorëve të Luftës në Bajram Curri, ndërsa emri i tij u skalit i pari në pllakën përkujtimore të dëshmorëve të Brigadës së XXV-të Sulmuese, në qendrën e Tropojës, në Aste.

Episodi 5 - Izolimi me Shqipërinë

Pas Luftës së Dytë Botërore, kufiri midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë u mbyll me një perde të hekurt. Deri në vitin 1948, Cuca – ose "Çika malësore", siç e thërrisnin – mund të shkonte e të vinte në gjini, në Malësinë e Gjakovës.

Lidhjen më të fortë ajo e mbante me një nga njerëzit më të dashur të saj, Isuf Çujin, djalin e vëllait të saj Sadik Ramës; me vëllezërit Ukë e Ahmet Mani; me Deli Qerimin dhe me shumë kushërinj të tjerë në Malësinë e Gjakovës.

Disa prej tyre jetonin ende në trojet e të parëve në Geghysen, të tjerë ishin zhvendosur në Bajram Curri, e disa në Shkodër. Me ta ajo shfrynte mallin për Ahmetin e vogël, djalin e rënë në luftë.

Por pas asaj që njihet si prishja e Informbyrosë – përçarja përfundimtare midis Enver Hoxhës dhe Titos në vitin 1948 – kufirit shqiptaro-shqiptar midis Plavës e Gucisë dhe Malësisë së Gjakovës iu vu përfundimisht një perde e hekurt.Tani, udhëtimi për në vendlindje nuk mund të imagjinohej e as të ëndërrohej — përveç nëse dikush do të merrte përsipër rrezikun më të madh: atë që paguhej me çmimin e jetës.

Episodi 6 - Arratisja e djemve drejt Shqipërisë

Kështu kaluan dhjetë vjet, derisa një ditë dy djemtë e saj, Isa dhe Imeri, vendosën të mos e duronin më zgjedhën robëruese jugosllave dhe kaluan kufirin, duke u shfaqur papritur në Bajram Curri.
Ata u paraqitën pranë organeve kompetente dhe zbuluan identitetin e tyre, të lidhur ngushtë me gjakun e të afërmve të nënës së tyre, Cucë Avdylja. Natyrisht, dy bijtë e një trimëreshe si ajo, dhe vëllezër të një dëshmori, pritej të trajtoheshin me njëfarë kujdesi të veçantë – ndryshe nga ajo që ndodhte zakonisht me "emigrantët", siç quheshin kosovarët që kalonin kufirin drejt Shqipërisë në atë kohë.
Megjithatë, as ata nuk gjetën një jetë të qetë e të rehatshme në Atdheun e tyre.

Episodi 7 - Ahmet Isw Ulaj – 9 vjeçar "Zot shtëpie"

Tani, familja Ulaj e Vuthajve kishte mbetur në duart e një djali 9-vjeçar – Ahmetit – që mbante emrin e xhaxhait të tij dëshmor. Bashkë me të, në shtëpi jetonin një grua e vetme, Cuca, dy nuse të reja – Zadeja dhe Vezirja – si dhe katër vajza, më e madhja vetëm 4–5 vjeçe: Nuria.

E mbetur njëkohësisht zonjë dhe zot shtëpie, nën trysninë e jashtëzakonshme të autoriteteve vendore jugosllave, në një zonë ku nacionalizmi i tërbuar malazez bënte kërdinë për të zhdukur praninë shqiptare, Cuca ia doli të mbante familjen të bashkuar dhe të ruante jo vetëm një farë mirëqenieje, por mbi të gjitha nderin e familjes dhe të fisit – tashmë të mbetur krejt në duart e saj.
Tani, mendja e saj punonte vetëm rreth një qëllimi: si të kthehej në origjinën e vet, të bashkohej me djemtë dhe të ndërtonin gjithçka nga e para.
Natyrisht, as që i shkonte në mendje ta bënte këtë duke lënë pas dy nuset e reja dhe pesë fëmijët që kishin lindur deri atëherë nga djemtë e saj – fëmijë që digjeshin nga malli për ta, nga ana tjetër e kufirit.

Episodi 8 - Cucë Avdylja bën planin e arratisjes për në Shqipëri.

Që nga dita kur djemtë e Cucë Avdyles u larguan nga Vuthajt dhe kaluan në Shqipëri, ajo mendonte ditë e natë vetëm për një gjë: si të ribashkonte familjen – nuset me burrat e tyre, dhe fëmijët me baballarët e tyre.

Por për ta realizuar këtë, ajo duhej të kalonte nëpër një varg të pafund rreziqesh.

Së pari, dihej botërisht se ajo dhe të gjithë të afërmit e saj ishin nën vëzhgimin e rreptë të organeve të sigurisë jugosllave dhe malazeze.

Së dyti, plani për arratisje duhej të ishte aq i fshehtë, saqë askush – madje as anëtarët e familjes – nuk duhej ta dinte. Mjaftonte një fjalë goje, e lëshuar pa kujdes në ndonjë bisedë me të afërm, për ta kompromentuar gjithë planin dhe për të rrezikuar që të gjithë të përfundonin në burg.

Me djemtë në Shqipëri, fëmijët pa baballarë, e nuset pa burrat e tyre në Mal të Zi – nën vëzhgimin dhe diskriminimin e vazhdueshëm malazezo-jugosllav – ajo përpunonte në heshtje planin se si të shpëtonte nga ajo mënxyrë.
Kjo ishte atmosfera kur Cucë Avdylja, trimëresha e atyre maleve, mori përsipër rrezikun më të madh që mund të marrë një njeri:

Arratisja!
Dilema e tmerrshme: Jeta ose Vdekja – për tetë pjesëtarët e familjes së saj. Më e vogla, as dy vjeçe!

Episodi 9 - Cucë Avdylja vëzhgon lëvizjet e patrullës jugosllave të kufirit.

Gjatë dy vjetëve që nga ikja e djemve në Shqipëri, Cuca, me një zgjuarsi të rrallë dhe një durim prej gruaje malësore, vëzhgonte me kujdesin më të madh lëvizjet e patrullës kufitare jugosllave. Posta e tyre ndodhej në fshatin Vuthaj, jo larg shtëpisë së Elez Hysenit.

Ajo i përkushtohej me përpikëri këtij vëzhgimi dhe me kalimin e kohës arriti të mësonte grafikun e lëvizjes së patrullës. Vuri re se një natë patrulla shkonte në një drejtim, natën tjetër në drejtimin e kundërt; pastaj dy net në të njëjtin drejtim dhe sërish dy net në drejtimin tjetër. Ky cikël përsëritej me një rregullsi pothuajse të njëjtë.

Duke ndjekur këtë grafik, Cuca bënte çdo ditë llogaritë dhe çdo mbrëmje vërtetonte parashikimet e saj. Ajo e kuptoi se kishte zbuluar një rend të fshehtë, një model që e ndihmonte të parashikonte me saktësi se në cilin drejtim do të nisej patrulla në natën vendimtare.

Episodi 10 - Cucë Avdylja iu bën të ditur nuseve të djemve planin e arratisjes

Pas dy vjetësh llogaritje thuajse matematikore, Cuca i thërret të dy nuset dhe u drejtohet me zë të qetë, por vendimtar.
Së pari i flet Zades – vajzës së njërit prej burrave më të njohur të shqiptarisë, jo vetëm në Mal të Zi, por edhe në Rrafshin e Dukagjinit – Zymer Haxhës:
– A je e bija e Zymer Haxhës ti?
Zadja nënqeshet dhe i përgjigjet me gjysmë zëri:
– Paj, s'besoj se ka kush që mundet me e vu në dyshim këtë!
Cuca e sheh drejt në sy dhe i thotë prerë:
– Atëherë, nëse je e bija e Zymer Haxhës, ke me shkue nesër në gjini. Ke me fjetë dy netë dhe me u kthye. Por kur të dalësh prej asaj shpije, mos i kallxo kujt. Veç me ua dhanë hallallin, se nuk dihet a i sheh ma kurrë në këtë jetë!
Të njëjtën fjalë ia përsërit edhe Vezires, nuses së djalit të dytë, Imerit.
Kështu, dy nuset nisen për në gjini. Pas dy netësh qëndrimi atje, kthehen në shtëpi – pa thënë asgjë, me zemrën plot ankth dhe me sytë që thonin më shumë se çdo fjalë.

Episodi 11 - Kush ishte Zade Zymerja?

Në fakt, Zadja ishte vetë një "Cucë" e dytë. Babai i saj, Zymer Haxha, ishte një ndër burrat më në zë të krahinës – një nga meshkujt më të pashëm në Mal të Zi dhe një nga kampionët e hipizmit në të gjithë Jugosllavinë.
I veshur me kostumin kombëtar shqiptar të asaj ane dhe i hipur mbi një kalë që dallohej ndër gjithë atllarët e krahinës, ai kalëronte në festa, në dasma e në gara, duke i dhënë hijeshi burrnisë shqiptare në çdo paraqitje.
Vetë Zadja ishte një nga gratë më fisnike, më të bukura dhe më stoike të tërë Plavës dhe Gucisë.

Episodi 12 - Përgatitjet për arratisjen

Ndërkohë, Cuca kishte përgatitur gjithçka për "udhëtimin" që i priste. Fëmijët ishin ende të vegjël, por Ahmeti, tanimë 9-vjeçar, e kuptonte shumë mirë çfarë po ndodhte. Ai e dëshironte me gjithë shpirt të bashkohej me babain dhe xhaxhain e tij në Shqipëri.

Edhe Nurija, ndonëse e vogël, ishte e gatshme – me atë dëshirën dhe naivitetin fëmijëror – të ndërmerrte një udhëtim biblik, duke u ngjitur pas nënës nëpër një rrëpirë mali shumë më të pjerrët se ajo që përshkoi Krishti drejt kryqit.

Cuca kishte përgatitur aq ushqim dhe ujë sa mendonte se do t'u mjaftonte për një udhëtim që do të zgjaste gjithë natën – nga Leskova e Vuthajve deri në majat e malit, përtej kufirit.

Episodi 13 - Vraçi i Familjes Ulaj që "ndihmoi" arratisjen

Në natën e datës ... gusht të vitit 1960, Cucë Avdylja doli, si çdo natë, për të marrë Vraçin e familjes Ulaj, i cili ende kulloste në livadhin pas shtëpisë, aty ku shiheshin qartë lëvizjet e patrullës së kufirit.

Ora e udhëtimit po binte bashkë me errësirën e natës. Cuca doli, ashtu si gjithmonë, dhe e mori "me të mirë" kalin. E lidhi për kërpeshi, hodhi sytë rreth e rrotull. Vështroi me kujdes për të parë nëse ushtarët e kufirit ishin nisur në drejtimin që ajo kishte parashikuar. Dhe ashtu ndodhi: pa vonuar, ata i hodhën peticat mbi supe, varën çantat në krahë dhe u nisën drejt veriut.

Cuca u kthye në shtëpi. E lidhi kalin në grazhd, e puthi në ballë dhe i dha lamtumirën... përgjithmonë.Brenda e prisnin dy nuset dhe pesë fëmijët. I vetmi që mund të përballonte ngjitjen e asaj maloreje të thiktë drejt drejt Shqipërisë, ishte Ahmeti. Katër të tjerët duhej të ndihmoheshin. Atyre ua kishin bërë gati pak bukë dhe ujë – sa për të përballuar një natë që mund të përfundonte ose në liri, ose në fundin e gjithçkaje.

Episodi 14 - Karvani tetë vetësh ngjitet natën bjeshkëve drejt Shqipërisë

Karvani, i përbërë prej shtatë femrave dhe një djaloshi 9-vjeçar, e nisi udhëtimin nga dera e shtëpisë së Elez Hysenit, në Leskovë të Vuthajve. Në heshtje të plotë morën rrugën drejt Gerlës, e më tej filluan ngjitjen, thikë përpjetë, përtej luginës me gurë dhe zall, buzë lumit që mezi dëgjohej.

Pastaj, duke u kapërthyer nëpër shkëmbinj: ec e ndalu! Ec e ndalu! Pusho. Merr frymë. Pi ujë. Jepu fëmijëve diçka për të futur në gojë. Dhe sërish: vazhdo në heshtje marshimin!

Nuk duhej lënë asnjë shenjë. Nuk duhej bërë asnjë zhurmë – sado e vogël. Shpejtësia e ecjes nuk mund të ishte më e madhe se ajo e një fëmije, për shkak të malores thuajse pingule, pengesave natyrore dhe barrës së fëmijëve të mbajtur në krah tërë kohën.

Por më e rëndë se lodhja ishte frika – mos vallë do të diktoheshin? Dhe një tjetër merak e mbyste zemrën e Cucës: a do të qëndronte pa qarë Hasimja e vogël, ende fëmijë djepi? Po Dusha, pak më e madhe? Apo Hasnija, që s'ishte veçse katër vjeçe?

Një e qarë e tyre mund të nënkuptonte fundin e gjithçkaje. Dhe ato nuk e dinin këtë. Ishin fëmijë. Të pafajshme. Të pambrojtura. Të marra në krah nga një nënë e sprovuar, që e kishte sfiduar kohën, sistemin dhe vdekjen – për të mbërritur në liri.

Episodi 15 Patrulla jugosllave fillon të qëllojë në drejtim të karvanit

Dalëngadalë, nata po i lëshonte vendin dritës së mëngjesit, kur karvani i arratisur po i afrohej majës së malit. Vetëm pak hapa i ndanin nga kufiri i ëndërruar, nga shpëtimi. Por pikërisht në atë çast, ndodhi e paimagjinueshmja: ata u diktuan nga forcat kufitare jugosllave.

Tani, të gjithë ishin në tehun e vdekjes. Një arratisje e tillë, kaq masive, vetëm me gra dhe fëmijë — ishte një akt i rrallë në gjithë Jugosllavinë komuniste dhe në tërë kampin lindor.

Patrulla ishte ende larg, por filloi të qëllonte me armë. Qentë e kufirit nisën të lehinin me tërbim. Cuca me të vetët i dëgjonin krismat, por, për fat, plumbat nuk po i kapnin. Zoti kishte vënë dorë: fishekët nuk mbërritën dot asnjërin prej tyre — as Cucën, as Zaden, as Veziren, as Ahmetin, as Nurijen, Hasnijen, Dushen apo Hasimen, e cila sapo kishte nisur të hidhte hapat e parë nëpër shtëpi.

Por lëvizja e tyre ishte e ngadalshme. Më shumë se marshim, ishte një ngjitje torturuese me frymën në fyt dhe frikën përpara. Ushtarët mund të afroheshin në çdo çast. Dhe po të ndodhte kjo, gjithçka do të përfundonte në tragjedi. Një fjalë e fundit, një frymë, një krismë — dhe historia do të shkruhej ndryshe.

Episodi 16 Qylymi që i shpëtoi jetën karvanit

Karvani kishte mbërritur pranë qafws së malit, por ende nuk kishte kaluar vijën kufitare. Përpara tyre shtrihej një zonë e dallueshme, e mbuluar me një çarçaf të bardhë bore, që nuk shkrihej kurrë në ato maja të përjetshme. Aty, ku gjurma kthehet në dëshmi dhe çdo hap mund të shndërrohet në grackë, zgjuarsia e Cucë Avdyles i erdhi në ndihmë trimërisë së saj të pashoqe.

Nga shpina ajo hoqi qilimin, të cilin e kishte marrë enkas për këtë moment. E shtriu mbi dëborën e ngrirë, vuri mbi të pesë fëmijët e vegjël, dhe me zë të prerë u tha dy nuseve:

“ Kapni cepat e përparmë! Unë do të marr të pasmet”!

Si një lundër në mes të stuhisë, gratë e tërhoqën qilimin përpjetë në atë faqe bore, ndërkohë që armët e patrullës jugosllave pëlcisnin pas shpinës së tyre.

— Stoj! Stoj! — dëgjohej klithma e ushtarëve, teksa krismat binin në ajër.

Por tani fati po u kthehej. Qilimi shpëtimtar rrëshqiste në një tëposhtëz bore me shpejtësi gjithnjë e më të madhe. Ishin tre avantazhe që po luanin në favorin e tyre:

1. Rrëshqitja e fëmijëve mbi qilim ishte shumë më e lehtë dhe më e shpejtë se ngjitja e ushtarëve me armë në sup;
2. Tashmë po dilnin nga rrezja e zjarrit dhe e shikimit të patrullës;
3. Dhe më e rëndësishmja – po i afroheshin kufirit me Shqipërinë.

Qilimi i bardhë, tashmë i njomur e i gërryer nga akulli dhe pesha, i rezistoi fërkimit mbi kokrrat e borës, duke u bërë dëshmitar i një epopjeje shpëtimi.

Dhe, kur gjithçka dukej e pamundur, para syve të tyre u shfaq piramida e kufirit: ajo shenjë e heshtur që ndante takat shqiptare nën jugosllavi nga toka shqiptare. Ishin në prag të Atdheut. Ishin gjallë.

Episodi 17 - Fundi i udhëtimit biblik

Tani kishin mbetur vetëm disa dhjetëra metra për të arritur vijën e shpëtimit – por atyre u dukeshin si kilometra të tëra. Ishte fundi i një udhëtimi të jashtëzakonshëm në historinë e njerëzimit, një marshim që për pak sa nuk u përmbyll në tragjedi, ose që – nëse ia dilnin – do të bëhej një nga aktet më madhështore të bashkimit njerëzor: nënës me bijtë, gruas me burrin, fëmijës me babanë.
Gratë, me një frymë të fundit, i dhanë qilimit të shpëtimit një tërheqje të fuqishme. Dihatura e tyre përzihej me thërrmijat e dëborës që ngrinin ajrin. Dhe pastaj… kaluan përtej piramidës!

Ishin në tokën e lirë të Shqipërisë.
Duhej edhe pak fuqi, ajo fuqi që Zoti ia jep njeriut në çastet e skajshme të jetës. Vazhdonin tërheqjen deri sa u rrëzuan mbi një rrip toke të fshehur nga syri dhe arma e ushtarëve jugosllavë. Aty, në gjirin e atdheut, morën frymë thellë. Ranë njëra mbi tjetrën. U përqafuan. Qanë me dënesë — nga gëzimi, nga lodhja, nga mallëngjimi për ata që kishin lënë pas.

Cucë Avdylja po i afrohej ditës më të madhe të jetës së saj – ribashkimit me djemtë e saj në tokën mëmë. Por në shpirtin e saj tashmë kishte një plagë të re: kishte lënë pas tre bijat e saj – Shemën, Baden dhe Fatimen – secila e martuar, me djem e vajza të vetat. Nuk e dinte nëse do t'i shihte më ndonjëherë. Dhe, në të vërtetë… nuk i pa kurrë më!

Episodi 18 - Brenda kufirit shqiptar

Tani krismat e armëve në anën jugosllave të kufirit sa vinin e afroheshin. Në anën shqiptare të kufirit ra alarmi për ndonjë përpjekje në kufi. Ushtarët shqiptarë, bashkë me qentë e erës, u shfaqën përpara atyre njerëzve. Pasi e kuptuan çfarë po ndodhte, ata menjëherë i morën në mbrojtje dhe i shoqëruan për në postën e kufirit dhe prej andej i përcollën për në jug.

Episodi 19 - Isë dhe Imer Ulaj në pritje të familjeve të tyre në Shqipëri.

Ardhja e Cucës në atë formë kishte ngjallur interesin e kujtdo, sepse emri i saj po kthehej në kujtesë. Ishte lufta me malazezët, plagosja e saj prej shkjaut dhe hakmarrja për vëllain e rënë, Ukshinin, i cili kishte mbetur i vrarë në përballje me malazezët. Pastaj rënia dëshmor e të birit, Ahmetit. Njerëzit e saj në Shqipëri menjëherë e morën vesh dhe e rrethuan me dashurinë e pafund që kishin ushqyer gjithmonë për të. Ajo u përjetua në këngë:…….

Jam e motra e Ukshin Avdylit.
Nuk më trembet qerpiku i synit,
Jam e motra e atij sokolit,
Sot ja muer shpirtin majorit,
Për pa u shëmbë Maja e Kores,

S'i nënshtrohna Cernagores,
Luftë po bajka n'majë t'thepit,
Cucë Avdylja e Geghysenit!

Episodi 20 - Trajtimi brutal i vajzës së Cucës, Bades, në Mal të Zi.

Ndërkohë që Cuca arrin në Shqipëri, menjëherë pas saj, një ngjarje tjetër e rëndë pllakos të bijën, Baden. Forcat e Sigurimit jugosllav vrasin dhëndrrin, bashkëshortin e Bades, Imer Imerin, bashkë me të vëllain dhe ua zhdukin trupat. Ndërsa gratë e tyre, Badja dhe Sosja, dy kunata, arrestohen bashkë me dy djemtë e Bades, binjakët Skënder dhe Nderim, dhe mbahen në burg. Arrestimi i dy binjakëve, që ishin vetëm dy vjeç, përbën një ndër rastet më të rralla të ndodhura ndaj fëmijëve, përveç atyre që ndodhën ndaj hebrenjve nga nazistët gjermanë gjatë Holokaustit. Ndërkohë që ishin në burg, Soses, kunatës së Bades, i lind një vajzë në qeli, dhe Badja i vendos emrin Burge! E pabesueshme, por e vërtetë.

Episodi 21 - Vendosja në Shpërdhet në Mamurras.

Me ardhjen në Shqipëri, familja Ulaj u vendos fillimisht tek Hani i Banit, midis Mamurrasit dhe Thumanës.
Vitet kaluan. Cuca me dy djemtë ndërroi shtëpi nga Hani i Banit, ose shtëpia e Zonjës së Inglizit, siç i thoshnin vendalinjtë, tek një shtëpi më afër qytezës së Mamurrasit, pranë rrugës që të çonte nga rruga nacionale për në qendrën e stërvitjes ushtarake studentore. Që andej, ata u vendosën në Shpërdhet, në Mamurras.
Në vitin 1972 ajo ndërroi jetë në një aksident.
U shua një jetë.
Në fakt, një histori.
Një epokë.
Por mbrapa la një emër të madh dhe një familje të madhe që sot luan një rol të shumw tw rëndësishëm në ndërtimin e Shqipërisë moderne.

Shënim:
Filmi, i bazuar në këtë libret, u realizua nga regjisori Ilir Kasneci dhe u transmetua nga televizioni A2 CNN. Ai është i aksesueshëm në platformën YouTube dhe deri më sot është parë nga mbi 4.500 shikues.

https://www.youtube.com/watch?v=JYN9zeXNAaY&t=41s

Bashkë me Me Dr. Ahmet Ulajn, nipin e Cucë Avdyles, bashkëudhëtar në arratisjen e treguar në këtë libret, gjatë një udhëtimi me traget nga Komani në Fierzë.

Me Dr. Ahmet Ulajn, motrën e tij Hasnijen (personazh i këtij dokumentari), të arratisurën e tregimit, dhe Donikën – në Vuthaj, vendlindjen e tyre.